



dy

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCEVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE

Nr. 81/28 Prot.

Tiranë, më 22.12 2017

URDHËR

Nr. 81 datë 22.12.2017

**“PËR
MIRATIMIN E MANUALIT TË SHËRBIMEVE PËR TATIMPAGUESIT DHE
INDIVIDËT”**

Në mbështetje të pikës 3, të nenit 135, të Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Miratimin e Manualit të Shërbimeve për Tatimpaguesit dhe Individët, sipas formatit bashkëlidhur.
2. Drejtoria e Shërbimit ndaj Tatimpaguesve si dhe Drejtoritë/Sektorët në varësi të tyre pranë Drejtorive Rajonale Tatimore, të marrin masat për respektimin e procedurave ligjore dhe përmbushjen e detyrave funksionale sipas edhe manualit të miratuar.
3. Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë. Me hyrjen në fuqi të këtij Urdhri, shfuqizohet nga të gjitha efektet ligjore Rregullore nr. 3, datë 11.10.2010, “Për ofrimin e asistencës dhe shërbimeve për tatimpaguesit e regjistruar dhe individët nga funksioni i shërbimit ndaj tatimpaguesve në Drejtoritë Rajonale Tatimore”.

DREJTORI PËRGJITHSHËM

Vasilika Viero

Adresa: Rr. Gjin Bue Shpata, pranë Stadiumit Dinamo
Tel: ++ 355 42276800, Fax: ++355 42276800

Web site: www.tatime.gov.al

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE

**MANUAL I SHËRBIMEVE
PËR
TATIMPAGUESIT DHE INDIVIDËT**

PËRMBAJTJA E LËNDËS

I. HYRJE	3
II. SHËRBIME QË OFROHEN NË SPORTELE DHE PRANË ADMINISTRATËS TATIMORE	4
A. VËRTETIME	4
1. Formularë të dyfishtë	4
2. Vërtetim për shlyerje të detyrimeve	4
4. Vërtetim për pagesën e tatimit në burim, për jo-rezidentët për të ardhurat që jo-rezidentët kanë përfituar me burim në R.SH.....	5
B. ÇERTIFIKATA	6
1. Çertifikatë rezidence për tatimpagues të regjistruar.....	6
2. Çertifikatë rezidence për Individ	7
C. SHËRBIME DHE PROCEDURA TË TJERA	8
1. Aplikimet për shmangien e taksimit të dyfishtë.....	8
2. Rivendosje Fjalëkalimi për tatimpaguesit e regjistruar.....	10
3. Kërkesë për rimbursim.....	10
4. Miratim për lëshimin e faturave kompjuterike.....	11
5. Marrëveshja e pagesës me këste.....	12
6. Urdhër zhbllokimi i llogarive bankare të tatimpaguesit.....	13
7. Urdhër zhbllokimi i aktivitetit në Doganë.....	13
8. Reflektimi i një (apo disa) gabimi/eve të shtypur/a mbi pajisjen fiskale.....	14
D. KËRKESAT MË TË SHPESHTA TË TATIMPAGUESVE NË E-FILING	14
1. Kërkesa për regjistrimin e përgjegjesisë tatimore:	14
2. Kërkesa për sistemim të situatave të ndryshme të tatimpaguesve:.....	14
3. Pyetje të përgjithshme në fushën e tatimeve	15
4. Kërkesa për ndryshimin e kategorisë së sigurimeve	15
5. Dorëzim dokumentash tatimore, inventarë etj	16
III. SHËRBIMET QË OFROHEN ONLINE	16
1. Vërtetim për regjistrim të investitorit.....	16
2. Vërtetim për pagesën e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore (për individin)	16
3. Vërtetim për pagesën e kontributeve për subjektin.....	17
4. Vërtetim për përgjegjësitë tatimore	18
5. Vërtetim statusi (aktiv – pasiv).....	18

6.	Vërtetim për shlyerje detyrimi (Në rast se janë shlyer detyrimet tatimore)	19
7.	Vërtetim për tatimpaguesit e regjistruar për qarkullimin e realizuar për 3 vitet e fundit:.....	20
8.	Vërtetim për posedim mjetei	20
9.	Vërtetim për individë të paregjistruar-	21

I. HYRJE

Administrata Tatimore ushtron detyrat e saj funksionale, bazuar në dispozitat e ligjit Nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH”, i ndryshuar, dhe aktet e tjera ligjore dhe nënligjore që plotësojnë kuadrin e legjislacionit tatimor. Neni 5/1, i Ligjit 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH”, i ndryshuar, përkufizon se “Administrata Tatimore” përfshin Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, dhe drejtoritë rajonale të ngarkuara për administrimin e tatimeve, taksave dhe kontributeve në nivel kombëtar dhe njësitë tatimore të qeverisjes vendore, të ngarkuara për administrimin e tatimeve, taksave dhe kontributeve në nivel vendor. Në vijim të përcaktimeve të tij, Ligji organik dhe aktet e tjera ligjore e nënligjore të dala në zbatim të tij, mirëpërcaktojnë kompetencat, atributet dhe detyrat funksionale të administratës tatimore. Administrata Tatimore, në përmbushje të detyrave të saj funksionale, është një institucion ekzekutues dhe zbatues, që udhëhiqet nga një sërë parimesh, ku ndër më kryesoret citojmë;

- *parimi për zbatimin e njëjtë dhe efektiv të legjislacionit për të gjithë tatimpaguesit;*
- *vetëvlerësimi dhe vetëdeklarimi i detyrimit tatimor nga ana e tatimpaguesit;*
- *nxitja e respektimit vullnetar të legjislacionit tatimor, nëpërmjet informimit, edukimit dhe publikimit të akteve nënligjore;*
- *hartimi i strategjive dhe marrja e masave përkatëse për pakësimin e rreziqeve që rezultojnë nga mosrespektimi i legjislacionit tatimor;*
- *ndjekja e ndryshimeve në mjediset e biznesit dhe atij legjislativ, si dhe përshtatja e sistemeve të organizimit të burimeve, të teknologjisë së informacionit dhe proceseve të punës, për arritjen e efikasitetit dhe të efektivitetit të duhur;*
- *nxitja e veprimtarive elektronike, sidomos të deklarimit dhe pagesës elektronike të detyrimit tatimor; etj*

Administrata Tatimore ofron shërbime të ndryshme, për bizneset ose qytetarët, si vërtetime, çertifikata, formularë etj. Brenda strukturës së administratës tatimore janë ngritur strukturat përgjegjëse për Shërbimin e Tatimpaguesve, si dhe është bërë efektiv komunikimi me tatimpaguesit për çdo paqartësi nëpërmjet Qendrës së Thirrjes, shërbimit live-chat etj. Për t'i ardhur në ndihmë të gjithë bizneseve, Administrata Tatimore duke bashkëpunuar me AKSHI-n sjell për tatimpaguesin edhe shërbimet online, nëpërmjet aksesimit në portalin e-Albania.

Manuali në vijim vjen në kuadër të lehtësimit të procedurave të ofrimit të shërbimeve online dhe ballë përballë si dhe informimit të të gjithë tatimpaguesve dhe jo vetëm, për shërbimet që ofrohen nga administrata tatimore.

II. SHËRBIME QË OFROHEN NË SPORTELE DHE PRANË ADMINISTRATËS TATIMORE

A. VËRTETIME

1. **Formularë të dyfishtë** Ky vërtetim lëshohet me qëllim çertifikimin e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të deklaruara dhe paguara për periudhën tatimore, për të cilën nuk është bërë dorëzimi i listapagesave në ISSHS. Çdo tatimpagues, i regjistruar më parë ka të drejtë të kërkojë vërtetim për formularë të dyfishtë (formulari i dyfishtë paraqitet nga individ i dhe jo tatimpaguesi). Ky vërtetim përfitohet pa pagesë apo tarifë shtesë dhe mund të përdoret nga individ për të përfituar nga skema e ndihmës ekonomike.

DOK. I KËRKUAR	DOK. QË SIGUROHET NGA VETË ADMINISTRATA	DOK. QË DUHET TË PARAQITET NGA KËRKUESI I SHËRBIMIT
1. Formularin e kërkesës 2. Formularin e dyfishtë 3. Dokument identifikimi 4. Autorizim (nëse kërkesa nuk paraqitet nga vetë individ)	1. Dokument identifikimi (nëpërmjet e-albania)	1. Formularin e kërkesës 2. Formularin e dyfishtë 3. Autorizim (nëse kërkesa nuk paraqitet nga vetë individ)

Hapat e procedurës:

- ✓ Çdo individ i interesuar, duhet të plotësojë formularin e kërkesës me shkrim pranë sportelit të Shërbimit të Tatimpaguesit, dhe ta dorëzojë atë.
- ✓ Formulari i dyfishtë duhet të jetë i plotësuar, firmosur dhe vulosur më parë nga ISSH për periudhën kur listëpagesat ndodhen në ISSH.
- ✓ Punonjësi i shërbimit të tatimpaguesit kryen verifikimin e situatës lidhur me deklarin në listëpagesën e periudhës në sistemin elektronik të administratës tatimore dhe pagesën e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.
- ✓ Punonjësi i shërbimit të tatimpaguesit duhet të bashkëpunojë me Drejtorinë Rajonale për saktësim të dhënash.
- ✓ **Afati i ofrimit të shërbimit: 1 ditë.**
- ✓ **Autoriteti përgjegjës: Drejtoria Rajonale Tatimore.**

2. **Vërtetim për shlyerje të detyrimeve.** Ky shërbim u ofrohet subjekteve të cilët mund të aplikojnë për t'u pajisur me vërtetim për pagim të detyrimeve dhe nuk mund ta marrin vërtetimin elektronikisht duke aplikuar nëpërmjet portalit e-albania, pasi mund të kenë detyrime për të cilat kanë bërë kërkesë për apelim, çështje në Gjykatë, nuk janë shfaqur ende në sistem pagesat e kryera, etj. Çdo subjekt tatimpagues ka të drejtë të kërkojë vërtetim për të verifikuar situatën në kohë reale të detyrimeve tatimore të tij. Vërtetimi përfitohet pa pagesë apo tarifë shtesë dhe mund të përdoret për t'u paraqitur si dokument në Tender, Ambasadë, Zyrën e Punës, Bankë, etj.

DOK. I KËRKUAR	DOK. QË SIGUROHET NGA VETË ADMINISTRATA	DOK. QË DUHET TË PARAQITET NGA KËRKUESI I SHËRBIMIT
1. Formulari i kërkesës 2. Dokument identifikimi 3. Autorizim (nëse kërkesa nuk paraqitet nga administratori)	1. Dokument identifikimi (nëpërmjet e-albania)	1. Formulari i kërkesës 2. Autorizim (nëse kërkesa nuk paraqitet nga administratori) (kur aplikimi kryhet në sportel)

Hapat e procedurës:

- ✓ Tatimpaguesi plotëson formularin “Kërkesë për Vërtetim”.
- ✓ Punonjësi i Shërbimit ndaj Tatimpaguesve bën verifikimin e situatës së borxheve në sistemin elektronik të administratës tatimore, si dhe në dosjen e tatimpaguesit në Drejtorinë Rajonale.
- ✓ Bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale për një verifikim më të saktë të situatës së Tatimpaguesit.
- ✓ **Afati i ofrimit të shërbimit: 1 ditë.**
- ✓ **Autoriteti përgjegjës: Drejtoria Rajonale Tatimore.**

4. **Vërtetim për pagesën e tatimit në burim, për jo-rezidentët për të ardhurat që jo-rezidentët kanë përfituar me burim në R.SH.** Ky shërbim ofrohet në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, në zbatim të dispozitave të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në R.SH”, i ndryshuar si dhe Udhëzimi nr. 24, datë 02.09.2008 “Për procedurat tatimore në R.SH”, i ndryshuar, lidhur me konfirmimin e pagesës së tatimit për të ardhurat që tatimpaguesit jorezidentë kanë përfituar me burim në Shqipëri.

Vërtetimi i shërben tatimpaguesit jorezident për t’a paraqitur në administratën tatimore të shtetit ku ai është rezident, me qëllim shmangien e tatimit të dyfishtë. Vërtetimi përfitohet pa pagesë apo tarifë shtesë dhe mund të përdoret vetëm për qëllime tatimore.

DOK. I KËRKUAR	DOK. QË SIGUROHET NGA VETË ADMINISTRATA	DOK. QË DUHET TË PARAQITET NGA KËRKUESI I SHËRBIMIT
1. Kërkesë me shkrim, ku të specifikohet: - emri dhe Nipti i tatimpaguesit që ka mbajtur tatimin në burim; - tatimpaguesi jo-rezident, nr. i tij i identifikimit për qëllime tatimore, rezidenca; - vlera e faturave të lëshuara, periudha për të cilën janë lëshuar këto fatura si dhe tatimi i mbajtur në burim.		1. Kërkesë me shkrim, ku të specifikohet: - emri dhe Nipti i tatimpaguesit që ka mbajtur tatimin në burim; - tatimpaguesi jo-rezident, nr. i tij i identifikimit për qëllime tatimore, rezidenca; - vlera e faturave të lëshuara, periudha për të cilën janë lëshuar këto fatura si dhe tatimi i mbajtur në burim. 2. Dokumenti që provon pagesën e tatimit në burim.

2. Dokumenti që provon pagesën e tatimit në burim.		Konkretisht: Konfirmimi i pagesës nga DRT përkatëse ku janë paraqitur paraprakisht kopjet e faturave dhe e regjistrimeve të mbajtura nga agjenti i tatimit në burim sipas nenit 35 të ligjit 'Për Tatimin mbi të Ardhurat').
--	--	---

Hapat e procedurës:

- ✓ Dorëzohet kërkesë me shkrim pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve ku të specifikohet:
 - Emri dhe Nipti i tatimpaguesit që ka mbajtur tatimin në burim;
 - Tatimpaguesi jo-rezident, nr i tij i identifikimit për qëllime tatimore, rezidenca;
 - Vlera e faturave të lëshuara, periudha për të cilën janë lëshuar këto fatura si dhe tatimi i mbajtur në burim.
- ✓ Bashkëlidhur kërkesës dorëzohet konfirmimi i pagesës së tatimit në burim, i marrë nga DRT përkatëse.
- ✓ Hartohet vërtetimi i pagesës së tatimit të mbajtur në burim.
- ✓ Dërgohet vërtetimi me postë në adresën e vendosur nga tatimpaguesi.
- ✓ **Afati i ofrimit të shërbimit: 30 ditë kalendarike.**
- ✓ **Autoriteti përgjegjës: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.**

B. ÇERTIFIKATA

1. **Çertifikatë rezidence për tatimpagues të regjistruar.** Lëshohet për tatimpagues të regjistruar në Administratën Tatimore që kanë realizuar të ardhura me burim jashtë Republikës së Shqipërisë, pas kërkesës me shkrim të tatimpaguesit me qëllim shmangien e tatimit në burim në vendin tjetër ku ai ka realizuar të ardhurat apo aplikimin e tarifës së reduktuar të tatimit në shtetin e burimit. Ky dokument provon se tatimpaguesi është rezident në Shqipëri dhe paguan tatimin në Shqipëri për të ardhurat/fitimet globale të realizuara. Çertifikata përfitohet pa pagesë apo tarifë shtesë dhe përdoret vetëm për qëllime tatimore.

DOK. I KËRKUAR	DOK. QË SIGUROHET NGA VETË ADMINISTRATA	DOK. QË DUHET TË PARAQITET NGA KËRKUESI I SHËRBIMIT
1. Kërkesë me shkrim		1. Kërkesë me shkrim, ku specifikohet viti, shteti dhe arsyeja për të cilat kërkohet çertifikata

Hapat e procedurës:

- ✓ Dorëzohet kërkesa me shkrim pranë DPT, në të cilën janë specifikuar viti, shteti dhe arsyeja për të cilën kërkohet çertifikata.
- ✓ Punonjësi përgjegjës, verifikon situatën e tatimpaguesit në sistemin elektronik të Administratës Tatimore, lidhur me regjistrimin, deklarin dhe statusin e tatimpaguesit.
- ✓ Hartohet çertifikata sipas formatit të miratuar.
- ✓ Dërgohet me postë sipas adresës së vendosur nga tatimpaguesi, dhe për dijeni Drejtorisë Rajonale Tatimore që ka në administrim tatimpaguesin, me qëllim verifikimin e deklarin të të ardhurave të realizuara jashtë, dhe pagesën e tatimit për këto të ardhura.
- ✓ **Afati i ofrimit të shërbimit: 5 ditë kalendarike.**
- ✓ **Autoriteti përgjegjës: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.**

2. **Çertifikatë rezidence për Individ** - Lëshohet për individët rezidentë për qëllime tatimore në Shqipëri (pavarësisht nëse kanë apo jo shtetësi shqiptare) që kanë realizuar të ardhura personale me burim jashtë Republikës së Shqipërisë, pas kërkesës me shkrim të individit me qëllim shmangien e tatimit në burim, në vendin tjetër ku ai ka realizuar të ardhurat apo aplikimin e tarifës së reduktuar të tatimit në shtetin e burimit.

Ky dokument provon se individi është rezident në Shqipëri, dhe paguan tatimin në Shqipëri për të ardhurat (personale) globale të realizuara. Çertifikata përfitohet pa pagesë apo tarifë shtesë dhe përdoret vetëm për qëllime tatimore.

DOK. I KËRKUAR	DOK. QË SIGUROHET NGA VETË ADMINISTRATA	DOK. QË DUHET TË PARAQITET NGA KËRKUESI I SHËRBIMIT
1. Kërkesë me shkrim. 2. Dokumenti që provon banesën e përhershme në Shqipëri 3. Qendra e interesave jetike (interesat personale & ekonomike) 4. Kohëqëndrimi në Republikën e Shqipërisë		1. Kërkesë me shkrim, ku specifikohet viti, shteti dhe arsyeja për të cilin kërkohet çertifikata. 2. Dokumenti që provon banesën e përhershme (kopje e aktit të pronësisë së banesës ose kopje e kontratës së qirasë ose vërtetim banese nga njësi administrative ku banon). 3. Vetëdeklarim lidhur me interesat jetike dhe ekonomike. P.sh.: nëse personi është shtetas i huaj, por rezident për qëllime tatimore në Shqipëri, ai deklaron se interesat e tij familjare janë të lidhura me Shqipërinë, pasi familja e tij

		jeton në Shqipëri dhe ai punon në Shqipëri (ka biznes apo është i punësuar). 4. Kohëqëndrimi në Republikën e Shqipërisë (shkresë nga D.P.P.SH, me të dhënat e hyrje-daljeve kufitare nga sistemi TIMS).
--	--	--

Hapat e procedurës:

- ✓ Dorëzohet kërkesë me shkrim, ku specifikohet viti, shteti dhe arsyeja për të cilin kërkohet çertifikata.
- ✓ Bashkëlidhur me kërkesën, është e nevojshme të depozitohet dokumenti që provon banesën e përhershme në Shqipëri (kopje e aktit të pronësisë së banesës ose kopje e kontratës së qirasë ose vërtetim banese nga njësia administrative ku banon).
- ✓ Personi vetëdeklaron në lidhje me interesat e tij jetike duke i bashkëlidhur kërkesës një kopje të dokumentacionit që provon deklarin e tij (interesat personale & ekonomike).
- ✓ Bashkëlidhur me kërkesën me shkrim, depozitohet shkresa e marrë nga D.P.P.SH, me të dhënat e hyrje-daljeve kufitare nga sistemi TIMS, për të vërtetuar kohëqëndimin në RSH (për vitin fiskal për të cilin kërkohet çertifikata e rezidencës).
- ✓ Hartohet çertifikata sipas formatit të miratuar.
- ✓ Dërgohet me postë sipas adresës së vendosur nga individi dhe për dijeni Drejtorisë Rajonale Tatimore përkatëse (Drejtoria Rajonale Tatimore më e afërt me vendbanimin e tij) me qëllim verifikimin e deklarin e tij të ardhurave të realizuara jashtë, dhe pagesën e tatimit mbi të ardhurat personale për këto të ardhura.
- ✓ **Afati i ofrimit të shërbimit: 10 ditë kalendarike.**
- ✓ **Autoriteti përgjegjës: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.**

C. SHËRBIME DHE PROCEDURA TË TJERA

1. Aplikimet për shmangien e taksimit të dyfishtë. I kërkohet subjekteve që kanë transaksione me persona të cilët janë rezidentë në vendet me të cilat kemi një marrëveshje tatimore në fuqi. Kërkesa për aplikimin e marrëveshjes tatimore, kryhet me anë të formularit të aplikimit të marrëveshjes tatimore. Ky formular ka për qëllim aplikimin e marrëveshjes për të ardhura me burim në Shqipëri (paguesi është tatimpagues Shqiptar) të realizuara nga persona që janë rezidentë në shtetin me të cilin është përfunduar Marrëveshja Tatimore. Aplikimi ka për qëllim shmangien e tatimit në burim apo pagesën e reduktuar të tatimit në burim (Shqipëri) për të të ardhurat që personat jorezidentë kanë përfituar me burim në Shqipëri. Nuk kërkohen pagesa apo tarifa shtesë për kryerjen e aplikimit dhe marrjen e përgjigjes zyrtare nga DPT. Përgjigja lidhur me aplikimin e bërë përdoret vetëm për qëllime tatimore.

DOK. I KËRKUAR	DOK. QË SIGUROHET NGA VETË ADMINISTRATA	DOK. QË DUHET TË PARAQITET NGA KËRKUESI I SHËRBIMIT
<p>1. Kërkesë me shkrim</p> <p>2. Formulari i aplikimit të marrëveshjes (origjinal i nënshkruar nga përfituesi i të ardhurave dhe autoriteti tatimor ku ai është rezident)</p> <p>3. Fotokopje e faturave.</p> <p>4. Kopje e njëhësuar me origjinalin në shqip e kontratës ndërmjet dy palëve</p>		<p>1. Kërkesë me shkrim</p> <p>2. Formulari i aplikimit të marrëveshjes (origjinal, i nënshkruar nga përfituesi i të ardhurave dhe autoriteti tatimor ku ai është rezident)</p> <p>3. Fotokopje e faturave.</p> <p>4. Kopje e njëhësuar me origjinalin në shqip e kontratës ndërmjet dy palëve</p> <p>Shënim: Nuk është e detyrueshme depozitimi i kontratës, nëse ajo është protokolluar më parë në D.P.T. Në këtë rast tatimpaguesi informon për referencat e shkresës me anë të së cilës ai ka protokolluar këtë dokument në D.P.T.</p> <p><u>Nëse nuk ka kontratë ndërmjet palëve, tatimpaguesi duhet të informojë në kërkesën e tij rreth fakteve të mëposhtme:</u></p> <p>a. Lloji i shërbimit të ofruar;</p> <p>b. Kohëzgjatja e këtij shërbimi;</p> <p>c. Mënyra e ofrimit të shërbimit (<i>on line, on site</i>);</p> <p>d. Nëse për ofrimin e shërbimit ka prezencë fizike në territorin e Republikës së Shqipërisë, të përcaktohet saktësisht kjo e fundit;</p> <p>e. të ndahen pagesat për të drejtat e përdorimit, markat tregtare, licencat etj, në furnizimet e përziera (shërbim + pagesa për honorare).</p>

Hapat e procedurës:

- ✓ Dorëzohet kërkesë me shkrim pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.
- ✓ Bashkëlidhur me kërkesën është e nevojshme sigurimi i formularit të aplikimit të marrëveshjes (origjinal, i nënshkruar nga përfituesi i të ardhurave dhe autoriteti tatimor ku ai është rezident), fotokopje e faturave dhe një kopje e njëhësuar me origjinalin në shqip të

kontratës (në lidhje me depozitimin e kontratës referohuni shënimit në pikën 4 në tabelën e mësipërme).

- ✓ Hartohet përgjigja në zbatim të dispozitave të marrëveshjes tatimore.
- ✓ Dërgohet shkresa (kthim përgjigje) me postë në adresën e vendosur nga tatimpaguesi, dhe një kopje për dijeni Drejtorisë Rajonale Tatimore përkatëse, e cila zbaton dispozitat e një marrëveshje tatimore vetëm pas shkresës zyrtare të DPT-së.
- ✓ **Afati i ofrimit të shërbimit: 30 ditë kalendarike.**
- ✓ **Autoriteti përgjegjës: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.**

- 2. Rivendosje Fjalëkalimi për tatimpaguesit e regjistruar** - Ky shërbim u vjen në ndihmë qytetarëve dhe bizneseve, me qëllim rivendosjen e fjalëkalimit për aksesimin e sistemit tatimet e mia (e-filing). Çdo tatimpagues i regjistruar më parë, ka të drejtë të kërkojë rivendosjen e fjalëkalimit. Ky shërbim përfitohet pa pagesë apo tarifë shtesë dhe mund të përdoret në momentet e humbjes së fjalëkalimit ose dyshimit për vjedhje të tij.

DOK. I KËRKUAR	DOK. QË SIGUROHET NGA VETË ADMINISTRATA	DOK. QË DUHET TË PARAQITET NGA KËRKUESI I SHËRBIMIT
1. Dokument identifikimi 2. Autorizim (nëse kërkesa nuk paraqitet nga administratori).	1. Dokument identifikimi (nëpërmjet e-albania).	1. Autorizim nëse kërkesa nuk paraqitet nga administratori.

Hapat e procedurës:

- ✓ Dorëzim i kërkesës me shkrim pranë punonjësit të Shërbimit të Tatimpaguesit.
- ✓ Hapat çështje në sistem nga punonjësi i Shërbimit të Tatimpaguesit për Ndryshim Fjalëkalimi të Tatimpaguesit prezent në sportel (ose personit të autorizuar prej tij).
- ✓ Gjenerohet automatikisht nga sistemi një fjalëkalim i ri, i cili përmban numra dhe shkronja.
- ✓ Printohet fleta me fjalëkalimin e ri, dhe i jepet tatimpaguesit.
- ✓ **Afati i ofrimit të shërbimit: Menjëherë.**
- ✓ **Autoriteti përgjegjës: Drejtoria Rajonale Tatimore.**

- 3. Kërkesë për rimbursim.** Ky shërbim u vjen në ndihmë qytetarëve dhe bizneseve të cilët kërkojnë një rimbursim për pagesën e tatimit mbi vlerën e shtuar tepër. Çdo subjekt ka të drejtë të kërkojë një rimbursim të tatimit mbi vlerën e shtuar të paguar tepër, nëse përmbush kushtet e parashikuara në ligj. Shërbimi ofrohet pa pagesë apo tarifë shtesë dhe mund të përdoret për t'u paraqitur si dokument sipas kërkesës.

DOK. I KËRKUAR	DOK. QË SIGUROHET NGA VETË ADMINISTRATA	DOK. QË DUHET TË PARAQITET NGA KËRKUESI I SHËRBIMIT
1. Kërkesa shkresore. 2. Kërkesa në formë elektronike. 3. Vërtetim nga banka me të dhënat e llogarisë të tatimpaguesit.	1. Vërtetim nga banka me të dhënat e llogarisë, kur e ka kërkesë të përsëritur.	1. Kërkesa shkresore. 2. Kërkesa në formë elektronike. 3. Vërtetim nga banka me të dhënat e llogarisë bankare në rastet kur bën një kërkesë për herë të parë ose kur ka ndryshime.

Hapat e procedurës:

- ✓ Dorëzohet kërkesë me shkrim, pasi të jetë dërguar edhe elektronikisht nëpërmjet sistemit elektronik (e-filing).
- ✓ I kthehet përgjigje tatimpaguesit brënda afateve ligjore.
- ✓ **Afati i ofrimit të shërbimit:**
 - Brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës së tatimpaguesve eksportues dhe eksportues me risk zero.
 - Brenda 60 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës së tatimpaguesve jo eksportues.
 - Autoriteti përgjegjës: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

4. Miratim për lëshimin e faturave kompjuterike. Ky shërbim i ofrohet tatimpaguesve si një lehtësi në veprimtarinë e tyre të përditshme, duke ju mundësuar gjenerimin e faturave tatimore të shitjes në format elektronik, me numër serial unik dhe të papërsëritshëm, të printuara nga sistemi i tij i regjistrimeve, në transaksionet e tyre të biznesit.

DOK. I KËRKUAR	DOK. QË SIGUROHET NGA VETË ADMINISTRATA	DOK. QË DUHET TË PARAQITET NGA KËRKUESI I SHËRBIMIT
1. Kërkesa shkresore. 2. Deklarata ose vërtetimi përkatës, në të cilin tregohet se sistemi i tij i regjistrimeve është i kompjuterizuar dhe i aftë të prodhojë fatura tatimore me numër serial unik dhe të papërsëritshëm për çdo transaksion. 3. Modeli i faturës sipas elementëve të	1. Ekstrakt i QKB. 2. Verifikimi i situatës aktuale të tatimpaguesit në sistem.	1. Kërkesa shkresore. 2. Deklarata ose vërtetimi përkatës, në të cilin tregohet se sistemi i tij i regjistrimeve është i kompjuterizuar dhe i aftë të prodhojë fatura tatimore me numër serial unik dhe të papërsëritshëm për çdo transaksion. 3. Modeli i faturës sipas elementëve të parashikuar

parashikuar në Nenin 101 të ligjit 92/2014. 4. Ekstrakt i QKB 5. Verifikimi i situatës aktuale të tatimpaguesit në sistem.		në Nenin 101 të ligjit 92/2014
--	--	--------------------------------

Hapat e procedurës:

- ✓ Dorëzohet kërkesa me shkrim pranë DPT.
- ✓ Punonjësi përgjegjës verifikon situatën e tatimpaguesit, në sistemin elektronik të administratës tatimore, lidhur me regjistrimin deklarimin dhe statusin e tatimpaguesit.
- ✓ Hartohet autorizimi sipas formatit të miratuar.
- ✓ Dërgohet me postë, sipas adresës së vendosur nga tatimpaguesi, dhe për dijeni Drejtorisë Rajonale Tatimore që ka në administrim tatimpaguesin.
- ✓ **Afati i ofrimit të shërbimit: Brenda 10 ditëve kalendarike.**
- ✓ **Autoriteti përgjegjës: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.**

5. Marrëveshja e pagesës me këste. Kur një rrethanë financiare pengon tatimpaguesin për të paguar në afat detyrimet tatimore, ai mund të lejohet të lidhë në çdo kohë marrëveshje pagese me këste. Në të njëjtën kohë tatimpaguesi, duhet të vërtetojë që është në kushtet e pamundësisë financiare për të paguar të plotë detyrimin tatimor, si dhe të tregojë që pavarësisht nga rrethana financiare, ai është në gjendje të përmbushë marrëveshjen.

DOK. I KËRKUAR	DOK. QË SIGUROHET NGA VETË ADMINISTRATA	DOK. QË DUHET TË PARAQITET NGA KËRKUESI I SHËRBIMIT
1. Kërkesë me shkrim. 2. Dokument pagese per 20% të vlerës së detyrimit ose garanci bankare. 3. Kartë identiteti.	1. Dokumenti pagesës shfaqet në sistemin informatik pas 2 ditësh.	1. Kërkesë me shkrim. 2. Dokument pagese për 20% të vlerës së detyrimit ose garanci bankare (Dokument i pagesës paraqitet nga subjekti në rastin kur Tatimpaguesi e kërkon këtë shërbim menjëherë ose pas një dite qe ka kryer pagesen e 20%). 3. Kartë identiteti.

Hapat e procedurës:

- ✓ Dorëzohet kërkesa me shkrim pranë DRT përkatëse.
- ✓ Punonjësi përgjegjës verifikon situatën e tatimpaguesit.
- ✓ Hartohet marrëveshja sipas kushteve përkatëse.
- ✓ Tatimpaguesi detyrohet të paguajë menjëherë të paktën njëzet për qind të vlerës së detyrimit, për të cilin lidhet marrëveshja ose të vendosi garanci bankare.
- ✓ **Afati i ofrimit të shërbimit: 10 ditë kalendarike.**
- ✓ **Autoriteti përgjegjës: Drejtoria Rajonale Tatimore.**

6. **Urdhër zhbllokimi i llogarive bankare të tatimpaguesit.** Administrata tatimore ka për detyrë të ndërpresë menjëherë zbatimin e masave shtrenguese në momentin kur tatimpaguesi shlyen plotësisht të gjitha detyrimet tatimore.

DOK. I KËRKUAR	DOK. QË SIGUROHET NGA VETË ADMINISTRATA	DOK. QË DUHET TË PARAQITET NGA KËRKUESI I SHËRBIMIT
1. Kartë identiteti.		1. Kartë identiteti.

Hapat e procedurës:

- ✓ Shlyerja e detyrimeve nga ana e tatimpaguesit.
- ✓ Punonjësi përgjegjës verifikon situatën e tatimpaguesit.
- ✓ Dërgohet urdhër zhbllokimi në bankat e nivelit të dytë.
- ✓ **Afati i ofrimit të shërbimit: Menjëherë.**
- ✓ **Autoriteti përgjegjës: Drejtoria Rajonale Tatimore.**

7. **Urdhër zhbllokimi i aktivitetit në Doganë.** Administrata tatimore ka për detyrë të ndërpresë menjëherë zbatimin e masave shtrenguese, në momentin kur tatimpaguesi shlyen plotësisht të gjitha detyrimet tatimore.

DOK. I KËRKUAR	DOK. QË SIGUROHET NGA VETË ADMINISTRATA	DOK. QË DUHET TË PARAQITET NGA KËRKUESI I SHËRBIMIT
1. Kartë identiteti.		1. Kartë identiteti.

Hapat e procedurës:

- ✓ Shlyerja e detyrimeve nga ana e tatimpaguesit.
- ✓ Punonjësi përgjegjës verifikon situatën e tatimpaguesit.
- ✓ Dërgohet urdhër zhbllokimi nga DRT tek Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (DPT).
- ✓ DPT dërgon urdhër zhbllokimi në doganë.
- ✓ **Afati i ofrimit të shërbimit: Menjëherë.**
- ✓ **Autoriteti përgjegjës: Drejtoria Rajonale Tatimore.**

- 8. Reflektimi i një (apo disa) gabimi/eve të shtypur/a mbi pajisjen fiskale.** Në rastet kur si rezultat i një gabimi të pavullnetshëm, nga ana e tatimpaguesit, është regjistruar një veprim shitje i porealizuar (gabim) dhe regjistrimi ka kaluar në memorien fiskale të pajisjes pa arkëtuar para nga ky veprim, administrata tatimore asiston tatimpaguesin në pasqyrimin e këtij gabimi në memorien fiskale.

Hapat e procedurës:

- ✓ Dërgimi i procesverbalit për gabimin e kryer në shtypjen e kasës fiskale, pranë DRT përkatëse.
- ✓ Tatimpaguesi do të vazhdojë të raportojë shitjet, raportime të cilat do të vazhdojnë të regjistrojë në vazhdimësi edhe këtë gabim.
- ✓ Punonjësi përgjegjës do të reflektojë gabimin në të dhënat e regjistruara në serverin e raportimeve të shitjeve në DPT duke e stornuar atë (nëpërmjet pasqyrimin në një kolonë të veçantë).
- ✓ Pas zbritjes së gabimit (stornimit), subjekti do të vazhdojë raportimin e shitjeve, të cilat do të mbartin në vazhdimësi gabimin, por nga stornimi i bërë nga DPT shifra e raportuar do të korrigjohet për të treguar xhiron reale.
- ✓ Mosnjoftimi i gabimit në regjistrim, është përgjegjësi e tatimpaguesit dhe konsiderohet shitje nga ana e tij.
- ✓ **Afati i ofrimit të shërbimit: Menjëherë.**

D. KËRKESAT MË TË SHPESHTA TË TATIMPAGUESVE NË E-FILING

- 1. Kërkesa për regjistrimin e përgjegjesisë tatimore:** Kjo procedurë i vjen në ndihmë subjeteve për të ndryshuar përgjegjësitë tatimore. Kjo procedurë ofrohet pa pagesë apo tarifë shtesë.

Hapat e procedurës:

- ✓ Tatimpaguesi dërgon kërkesën nga e-filing, nëpërmjet “Pyetje të përgjithshme”.
- ✓ Shqyrtimi i çështjes nga inspektori përgjegjës.
- ✓ Njoftimi i tatimpaguesit për ndryshimin e përgjegjësive.
- ✓ **Afati i ofrimit të shërbimit: 2 ditë.**
- ✓ **Autoriteti përgjegjës: Drejtoria Rajonale Tatimore.**

- 2. Kërkesa për sistemim të situatave të ndryshme të tatimpaguesve:** Kjo procedurë i vjen në ndihmë qytetarit dhe biznesit me qëllim rregullimin e situatës së tij (përgjegjësive tatimore, pasaktësive në vetëdeklarime etj.). Kjo procedurë ofrohet pa pagesë apo tarifë shtesë.

Hapat e procedurës:

- ✓ Tatimpaguesi dërgon kërkesën nga e-filing, nëpërmjet “Pyetje të përgjithshme”.
- ✓ Shqyrtimi i çështjes nga inspektori përgjegjës.
- ✓ Njoftimi i tatimpaguesit për kryerjen e sistemit përkatës.
- ✓ **Afati i ofrimit të shërbimit: 7 ditë kalendarike.**
- ✓ **Autoriteti përgjegjës: Drejtoria Rajonale Tatimore.**

3. Pyetje të përgjithshme në fushën e tatimeve (lindja e detyrimeve tatimore, situata financiare etj). Ky shërbim i vjen në ndihmë qytetarëve dhe bizneseve, me qëllim qartësimin dhe informimin e tyre për çdo problematike ose çështje që lidhet me fushën tatimore si dhe kuptimin dhe zbatimin e legjislacionit tatimor.

Brenda struktures së administratës tatimore, janë ngritur strukturat përgjegjëse si call center etj për orientimin, informimin e qytetarëve dhe tatimpaguesve. Shërbimi ofrohet pa pagesë apo tarifë shtesë dhe mund të përdoret në çdo kohë nëpërmjet rrjeteve të komunikimit si: email, telefon, chat. Një informacion të detajuar mund ta gjeni duke vizituar faqen zyrtare të internetit të tatimeve www.tatime.gov.al.

- ✓ **Afati i ofrimit të shërbimit: 1 ditë.**
- ✓ **Autoriteti përgjegjës: Drejtoria Rajonale Tatimore.**

4. Kërkesa për ndryshimin e kategorisë së sigurimeve: - Kjo procedurë i vjen në ndihmë qytetarit me qëllim përditësimin e të dhënave lidhur me kategoritë e sigurimeve. Kjo procedurë ofrohet pa pagesë apo tarifë shtesë.

Hapat e procedurës:

- ✓ Tatimpaguesi dërgon kërkesën nga e-filing, nëpërmjet “Pyetje të përgjithshme” lidhur me ndryshimin e kategorisë së sigurimeve, konkretisht:
 - I vetëpunësuar pa punëmarrës dhe punonjës të papaguar të familjes;
 - I vetëpunësuar me punëmarrës dhe punonjës të papaguar të familjes;
 - I vetëpunësuar me punëmarrës;
 - I vetëpunësuar (I vetëm);
 - Punëdhënës.
- ✓ Hapja e çështjes në sistem nga punonjësi përkatës.
- ✓ Njoftimi i tatimpaguesit për kryerjen e regjistrimit nëpërmjet e-filing.
- ✓ **Afati i ofrimit të shërbimit: 1 ditë pune.**
- ✓ **Autoriteti përgjegjës: Drejtoria Rajonale Tatimore.**

5. Dorëzim dokumentash tatimore, inventarë etj: - Ky është një shërbim që u vjen në ndihmë tatimpaguesve duke sqaruar procedurën e dorëzimit të dokumentacionit tatimor, në përmbushje të kërkesave ligjore.

✓ **Afati i ofrimit të shërbimit: Menjëherë.**

III. SHËRBIMET QË OFROHEN ONLINE

